

AKTI I THEMELIMIT
Te shoqerise “Shelgu Group” Sh.P.K
NENI 1

Shoqeria private “Shelgu Group” Sh.P.K formohet sot dt 14.09.2022 nga ortaku i vetem: *Herald Kodra*, atesia Lulzim, amesia Dhurata, shtetas Shqiptar, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, me adrese Rruga “Gjik Kuqali”, Njesia Administrative Nr.5, lindur me 26/04/1987, gjendja civile “beqar”, me nr personal I70426064B.

NENI 2
SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rr “Irfan Tomini”, Z.K 8220, Dyqani nr.1, nr pasurie 6/237-N2, Pallat 10 KT, Tirane.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, me zgjerimin e aktivitetit, me miratimin e gjithe ortakeve, ne te gjithe territorin e Shqiperise dhe jashte saj.

NENI 3
KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Afat i ushtrimit te veprimtarise se shoqerise eshte 10 vjet duke filluar nga data e regjistrimit ne regjistrin Tregtar .

NENI 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte: Sigurimi i objekteve Publike dhe Private ne pronesi ose ne perdorim te personave Fizik dhe Juridike, qe ushtrojne veprimtari ne Republiken e Shqiperise. Sigurimin dhe mbrojtjen e jetes dhe shendetit te Personave fizike, shtetas shqiptare ose te huaj. Ruajtja me ane te montimit te sistemeve te alarmit, sinjaleve dhe sistemeve te tjera te sigurise. Shoqerimin e vlerave monetare e materiale ose sendeve te cmuara gjate transportimit te tyre. Konsulence dhe analize e sigurise. Projekt instalimi dhe furnizimi si dhe mirembajtje te sistemeve te inteligjences. Furnizim, instalim, shitje dhe mirembajtje te pajisjeve te telekomunikacionit. Import-eksport me shumice dhe pakice, projektimin, instalimin te mjeteve dhe pajisjeve te vezhgimit, radiokomunikimit, audiovizive, fikjes se zjarrit, nderlidhjes, pajisjeve elektrike dhe elektronike si dhe te navigacionit, mjeteve te akses kontrolli. Import, eksport, tregti me pakice dhe shumice, sherbime, ekspertize, konsulence teknike, instalim, mirembajtje, logjistike, trajnime, certifikime personale, realizimin e studimeve dhe kerkimeve, auditim dhe prodhim ne fushat ICT/Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit, Big Data/Te dhena te larta kompjuterike, AI/Inteligjence Artificiale dhe Cyber Security/ Siguri Kibernetike, software dhe hardware te sistemeve informatike dhe telematike. Import dhe eksport, tregti me pakice dhe shumice, mbajtja, riparimi dhe marrja me qira e pajisjeve dhe mjeteve elektronike per perpunimin e te dhenave; menaxhimi i qendrave te perpunimit te te dhenave dhe te rrjeteve informatike te cdo lloj, realizimi i mandateve dhe i nen mandateve me dhe pa depozite per shitjen e software, rrjeteve informatike, hardware dhe objekteve ne pergjithesi per perpunimin e te dhenave si dhe sherbimeve te lidhura me to. Hartimi dhe realizimi i objekteve tre-dimensionale te grafikeve 3D. Operacione tregtare, industriale, me pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme te dobishme, duke perfshire edhe dhenien e garancive personale dhe reale edhe per palet e treta. Shoqeria mund te punesoje dhe te pranoje agjensi, komisione, perfaqesim dhe mandatim.

Veprimtari ne fushen e ndertimit, ndertim rrugeshe e veprash te tjera te lidhura me to, ndertim apartamentesh, vilash, ndertime shume kateshe, fshat turistik etj. Import eksport dhe tregtim te materialeve te ndertimit, inerte, etj. Veprimtari ne fushen e minierave, projektim shfrytëzim te kariereve gelqerore, prodhim te derivateve (inerte) dhe tregtimin e tyre, montim linjash betoni dhe prodhim i tij. Ofrimin e sherbimit per pastrimin e qytetit me ane te grumbullimit dhe traportimit te



mbetjeve urbane dhe tregjeve, fshirjen dhe larjen e rrugeve dhe trotuareve me punetore, larje dhe dezinfektim i konteniereve, grumbullim dhe transportim i mbetjeve inerte dhe te vellimshme, mirembajtje rruges kryesore, pastrimin e tregjeve, mbledhjen e mbeturinave ne territoret e banimit apo akseve rrugore.

Prodhimi i te gjitha llojeve te inerteve dhe materialeve te ndertimit. Tregtim me shumice dhe pakice, Import-Eksport te tyre dhe te mallrave te ndryshem, skrapit etj. Shfrytezimit te mineraleve per ndertim, prodhim rere, granil,cakull,punime me lende plasese. Ndertim objektesh, sistemime, rikonstruksione. Tregtim prodhimesh te ndryshme druri, duralumini, karburantesh me pakice. Autoshkolle, sherbime funerale etj. Tregtime me shumice dhe pakice te makinerive dhe pjeseve te kembimit te tyre per gurore dhe miniera, per industri perpunuese dhe agroperpunuese, ne fushen inxhinierike dhe mekanike , fadroma, ekskavatore, makina te ndryshme etj. Punime te ndryshme ne fushen e ndertimit si nenkontraktore me te tretet. Punime, tregti me shumice dhe me pakice dhe sherbime me lende plasese per perdorim civil per te trete si subjekt i specializuar ne kete fushe. Import-eksport te lendes plasese per perdorim civil. Tregtim me shumice dhe pakice i saj. Import Eksport, blerje, sshitje automjetesh dhe pajisje te ndryshme transporti. Import-eksport te pajisjeve robot te teknologjise se zhvilluar elektronike ne fusha te ndryshme si ato te industrise, bujqesise, shendetesise, sportit, ekonomise, transportit, etj. Dhenie cadra plazhi dhe shezllon plazhi me qira ne zona bregdetare apo dhe jo.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise ne para eshte:

Ortaku *Herald Kodra*, vlera e kapitalit ne para 100.000 (njqind mije) leke, nr i pjeseve 1(nje) kuote, Pjesmarrja ne perqindje 100%.

Pjese e kapitalit themeltar, jane lirisht te transferueshme, ne raste ndarje pasurore ndermjet bahkeshorteve, si dhe ne rruge trashegimie.

NENI 6

Per kryerjen e veprimtarise se saje shoqerija do te lidhe kontrata dhe do te hyje ne maredhenie me persona juridike dhe fizike, vendas dhe te huaj, banka dhe institucione financiare Shqiptare dhe te huaja.

NENI 7

Ortaku i vetem dhe te punesuarit ne shoqeri jane te detyruar te marrin te gjitha masat per rritjen e kapitalit te shoqerise, detyrohen te ruajne karakterin e fshehte te dokumentacionit, te informatave, te njohurive te fituara gjate aktivitetit te shoqerise dhe te marrin masat e nevojshme, per mos dekonspirimin e tyre.

Ata pergjigjen qofte edhe pjeserisht kur nga kjo shkelje vijne pasoja te demshne ekonomike per shoqerine.

NENI 8

Organet e shoqerise jane :

- Administratori i emeruar .
- Eksperti Kontabel i autorizuar.

NENI 9

Si regull mbledhjet e Ortakut te vetem zhvillohen ne vendin ku eshte selia e shoqerise.

Per cdo mbledhje mbahet nje proces verbal. Administratori cakton nje sekretare per mbajtjen e procesverbalit.

NENI 10

Administrartori fillimisht zgjidhet per nje afat kohor prej 3 vjet me te drejte rizgjedhjeje.

Administratori ka pergjegjei penale per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Administratori i shoqerise eshte **Herald Kodra**. Te drejtat dhe detyrat e administratorit caktohen ne statut.

NENI 11

Veprimtarija financiare e shoqerise mbyllet ne 31 Dhjetor te cdo viti.

Te ardhurat neto qe realizohen pas zbritjes se shpenzimeve, te detyrimeve financiare, te rezerves se domosdoshme dhe fondit qe do te perdoret per riinvestime te reja ndahen si fitime ne forme dividendesh ne raportet e kapitalit te ortakeve.

Fitimet mund te transferohen jashte shtetit pa asnje kufizim .

NENI 12

Ne rast se ndonje nga pikat e aktit ose statutit te shoqerise, nuk eshte ne perputhje me legjislacionin Shqiptar, ne asnje rast nuk mund te sjelle pavlefshmerine e te gjithe aktit dhe statutit te shoqerise, por kjo mos mareveshje mund te zgjidhet ne baze te legjislacionit shqiptar menjehere mbas konstatimit te saje .

NENI 13

Ky akt u perpilua ne kater kopje, me fuqi te barabarte,nga te cilat nje depozitohet ne Noteri, nje ne zyren ku ndodhet Regjistri Tregtar dhe dy ruhen ne Seline e Shoqerise , dhe si u kuptua nga palet u neneshkrua regullisht prej tyre .Ky akt hyn ne fuqi menjehere me neneshkrimin e tije nga ortaket dhe regjistrimin ne Regjistrin Tregtar .

ORTAKU I VETEM

Herald Kodra

Herald Kodra
